

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AMG CALL” shpk

Neni 1 - Emri

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “AMG CALL” më poshtë do të quhet “**Shoqëria**”.

Neni 2 - Themeli

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

Neni 3 - Selia

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Zona Kadastrale me nr. 8524, Lagja “Aqif Pasha”, Pall. 30/2, shkalla 1, kati i 3-të, Elbasan, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

Neni 4 - Ortaku i Vetëm

4.1 Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

- Z. Gëzim Demallari, i biri i Bajram dhe i Ylviqe, i dtl. 09.05.1979, lindur dhe banues në Elbasan në Lagjen “Skenderbej”, Rruga “Ruga Xhemali Voçi”, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030507708 dhe nr. personal H90509186C, lëshuar nga MB në dt. 06.01.2011.

Neni 5 - Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ne vlerën 100,000 leke i ndarë në 1 pjesë, me vlerë nominale 100,000 Lekë. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortaku i vetëm themelues.

5.2 Kuotat, me vendim te Ortakut të Vetëm, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës se shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjeter të parashikuar nga ligji.

Neni 6 - Objekti

6.1 Objekti i Shoqërisë është:

Call Center

Neni 7 - Kohëzgjatja

7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

1


Neni 8 - Kompetencat e Ortakut të Vetëm

8.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri te tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

Neni 9 - Administrimi i Shoqërisë

9.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- Z. Gëzim Demallari, i biri i Bajram dhe i Ylvije, i dtl. 09.05.1979, lindur dhe banues në Elbasan në Lagjen "Skenderbej", Rruga "Xhemali Voçi", mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030507708 dhe nr. personal H90509186C, lëshuar nga MB në dt. 06.01.2011.

9.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe do te qëndrojë në detyrë për një afat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Administratorët emërohen dhe shkarkohen nga detyra në çdo kohë me vendim të Ortakut të Vetëm dhe/ose në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 10 - Ligji i Zbatueshëm

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes pranë Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor Elbasan.

10.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar sot më datë 15.08.2018, nga Ortaku i Vetëm, Z. Gëzim Demallari.

Gëzim Demallari
